



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0850**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Isa Hasani Anetar dhe Batisha Ibrahim Anetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AVAG GROUP SH.P.K., " Global Holding " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, Vendimin për dhënie të një k të MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI me numër të prokurimit 214-25-4909-2-1-1, më 27.10.2025 mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE Avag Group SH.P.K., me nr. 2025/0850, e datës 04.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - II me numër të prokurimit 214-25-4909-2-1-1, anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin për LOT II dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. si dhe aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Global Holding SH.P.K., me nr. 2025/0861, e datës 05.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I me numër të prokurimit 214-25-4909-2-1-1, anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin për LOT I dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3.Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues aprovohen, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

**- Faktet dhe rrethanat procedurale -**

Me 04.06.2025, MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI me numër të prokurimit 214-25-4909-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratave për Lot I **240,000.00 €** dhe II: **240,000.00 €**.

Me 13.08.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë OE Ejona SH.P.K., për Lot II dhe Lurn Sh.P.K për Lot I.

Me 18.08.2025, OE AVAG GROUP SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 18.08.2025 po ashtu edhe OE Global Holding SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 27.08.2025, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 04.09.2025, OE AVAG GROUP SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0850/2025 ndërsa me datë 05.09.2025 OE Global Holding SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0861/2025.

**-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-**

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0850/2025 dhe ankesa nr. 0861/2025 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AVAG GROUP SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Parashtruesi i ankesës, OE “AVAG GROUP” Sh.p.k., vlerëson se vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i kundërligjshëm. Ky vendim nuk përmban asnjë vlerësim të argumentuar me shkrim lidhur me pretendimet dhe faktet e paraqitura në ankesë, duke lënë pa trajtim çështjet thelbësore të ngritura nga ankuesi. Në këtë formë, vendimi nuk siguron një zgjidhje të drejtë dhe të ligjshme të mosmarrëveshjes, në kundërshtim

me dispozitat relevante ligjore dhe me kërkesat e dosjes së tenderit.

Tutje, ankuesi konsideron se AK ka zhvilluar procesin e vlerësimit dhe ka marrë vendimin përfundimtar në lidhje me Llot 2 në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik dhe kriteret e vlerësimit të përcaktuara në nenin 59.4 dhe nenin 60 paragrafi 1.1 të LPP-së, të ndërlidhura me nenin 40.6 të RRPP-së. Konkretisht, oferta e OE ankues, e përgjegjshme dhe me çmim më të ulët, është eliminuar në kundërshtim me nenin 60 paragrafi 1.1 të LPP-së, ndërsa kontrata është dhënë OE-së “EJONA” Sh.p.k., ndonëse i njëjti operator nuk i plotëson kriteret për t’u konsideruar i përgjegjshëm në kuptim të nenit 59.4 të LPP-së dhe nenit 40.6 të RRPP-së, pasi nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat e njoftimit të kontratës dhe dosjes së tenderit.

Kjo për faktin se e ka eliminuar ofertën tonë të përgjegjshme me çmim më të ulët në kuptim të nenit 60 paragrafi 1.1 të LPP-së dhe, për rrjedhojë, e ka shpërblyer me kontratë OE “EJONA” Sh.p.k., pavarësisht se i njëjti nuk i përmbush kriteret për t’u kualifikuar i përgjegjshëm në kuptim të nenit 59.4 të LPP-së dhe nenit 40.6 të RRPP-së, pasi nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.

Kjo nënkupton se çmimi më i ulët është parakusht dhe vlerësohet vetëm pasi të jetë konstatuar se një ofertë i përmbush të gjitha kërkesat e kualifikimit dhe ato teknike të parashtruara në dosjen e tenderit, e që në rastin konkret OE i rekomanduar me kontratë nuk i ka përmbushur.

Këto veprime përbëjnë shkelje të parimeve themelore të vlerësimit të garantuara me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 02/L-042 (versioni i konsoliduar), si dhe me Rregulloren për Prokurim Publik Nr. 001/2022. Konkretisht, janë shkelur dhe anashkaluar dispozitat e mëposhtme:

LPP-së – dispozitat e listuara si më poshtë:• Nenin 1 në paragrafin 2 dhe 3 të LPP-së, lidhur me nenin 4.3 të RRPP-së;• Nenin 6 në paragrafin 1 të LPP-së;• Nenin 7 në paragrafin 1 dhe 2 të LPP-së;• Nenin 10 në paragrafin 4 dhe 5, lidhur me nenin 11 paragrafi 4 të LPP-së;• Nenin 59 në paragrafin 4 të LPP-së;• Nenin 60 në paragrafin 1.1 dhe nenin 28 të LPP-së;• Nenin 69 në paragrafin 4.1 dhe 4.2 të LPP-së;• Nenin 108/A në paragrafin 12 të LPP-së.

RRPP Nr. 02/2024 (Versioni i Konsoliduar) – dispozitat e listuara si më poshtë:• Nenin 4(3) të RRPP-së;• Nenin 40 në paragrafin 1 dhe 6 të RRPP-së;• Nenin 62 paragrafi 2 të RRPP-së.

Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative – dispozitat si më poshtë:• Neni 48 paragrafi 1 i LPPA Nr. 05/L-031.

Më datë 05.06.2025, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (në vijim: AK-MPB), ka publikuar në procedurë të hapur dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I, II, III, IV, V dhe VI", me numër të prokurimit 214-25-4909-2-1-1 dhe me vlerë totale të parashikuar prej 1,320,000.00 € e ndarë në 6 lote.

Parashtruesi i ankesës ka marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit për Llot II, duke ofertuar me çmim prej 239,400.00 €. Në krahasim me ofertuesin e vetëm për këtë lot, OE "EJONA" Sh.p.k., i shpallur fitues me çmim prej 214,444.80 €, ankuesi ka përmbushur të gjitha kriteret e kualifikimit dhe kërkesat teknike, si dhe kriterin e vlerësimit të përcaktuar në dosjen e tenderit dhe në nenin 59.4 dhe nenin 60 paragrafi 1.1 të LPP-së. Në këtë mënyrë, OE ankues vërteton statusin e palës me interes në këtë aktivitet prokurimi, sikurse parashihet me nenin 4 paragrafi 1

nënparagrafi 26 të LPP-së.

Më datë 13.08.2025, Autoriteti Kontraktues - MPB ka publikuar vendimin e tij të shoqëruar me njoftimet standarde për tenderuesit, përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë OE "EJONA" Sh.p.k., me çmim prej 214,444.80 €, në kuadër të aktivitetit të prokurimit me numrin dhe emërtimin e përshkruar më sipër. Për këto arsye, më datë 18.08.2025 kemi parashtruar një kërkesë shtesë pranë AK - MPB për të na siguruar në formë elektronike një kopje të materialit nga dosja e ofertës së OE fitues, konkretisht dokumentacionin e bashkëngjitur me dosjen e tij/saj lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesional, që do ta paraqesim tek pjesa e pretendimeve ankimore.

Gjatë shqyrtimit dhe analizimit të një pjese të pjesshme të dokumentacionit që e kemi siguruar gjatë qasjes në dosjen e paraqitur nga OE fitues (listën e referencave, listën e stafit, sigurimin e tenderit, deklaratën nën betim dhe ofertën financiare), kemi gjetur se ky i fundit nuk i ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të kërkesave themelore të kualifikimit dhe teknike, të cilat janë parashtruar në dosjen e tenderit, e të cilat do t'i paraqesim tek pjesa e pretendimeve ankimore.

Për këto arsye, dhe duke qenë se jemi dëmtuar nga aktet dhe veprimet e kundërligjshme të AK, të cilat nuk e pasqyrojnë zgjidhjen e drejtë dhe të ligjshme të përcaktuar me LPP, ngase vlerësimi dhe ekzaminimi i tenderëve nuk është bërë në përputhje me kërkesat teknike dhe të kualifikimit të parashtruara në dosjen e tenderit, si dhe me dispozitat relevante të LPP dhe legjislacionit sekondar RRPP, bazuar në procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-MPB.

Më datë 26.08.2025, AK - MPB, tetë (8) ditë pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim, ka nxjerrë vendimin me shkrim me të cilin e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka lënë në fuqi përzgjedhjen e AK që OE "EJONA" Sh.p.k. të shpallet fitues lidhur me aktivitetin e prokurimit me numrin dhe emërtimin e përshkruar më sipër. Vendimi është publikuar në platformën e-prokurimi me datë 26.08.2025 në ora 17:41 (pas skadimit të orarit). Ky vendim nuk përmban asnjë vlerësim të argumentuar me shkrim lidhur me pretendimet dhe faktet e paraqitura në ankesë, duke lënë pa trajtim çështjet thelbësore të ngritura nga ankuesi. Në këtë formë, vendimi nuk siguron një zgjidhje të drejtë dhe të ligjshme të mosmarrëveshjes, në kundërshtim me dispozitat relevante ligjore dhe me kërkesat e dosjes së tenderit.

Për këto arsye, duke qenë se na është shkelur e drejta e shpërblimit me kontratë nga veprimet dhe vendimet e AK, i cili nuk ka ndërmarrë asnjë veprim korrigjues për të mënjeluar shkeljet gjatë procesit të vlerësimit dhe vendimmarrjes, jemi detyruar t'i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me këtë ankesë formale, me qëllim mbrojtjen e të drejtës sonë ligjore, e cila vlerësojmë se mund të sigurohet në këtë fazë përmes një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm, në përputhje me nenin 104, nenin 105 dhe nenin 117 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

## 2. Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimi për: Kundërshtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga OE ankues "AVAG GROUP" Sh.p.k., si vendim i pabazuar në fakte dhe në dispozita ligjore.

Autoriteti Kontraktues - MPB, përmes vendimit të publikuar në platformën e-prokurimit më datë 26.08.2025 në ora 17:41, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga OE

"AVAG GROUP" Sh.p.k. Ky vendim është marrë pa dhënë asnjë arsyetim të argumentuar dhe të mbështetur në fakte apo në dispozitat përkatëse ligjore në fuqi lidhur me kundërshtimin e pretendimeve të paraqitura.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë fakt dhe as nuk ka ofruar shpjegim se mbi çfarë baze konsideron të pabazuar kërkesën tonë, duke mos dhënë argumentim me fakte të provuara për të vërtetuar pretendimin thelbësor mbi përgjegjshmërinë ligjore dhe faktike të ofertës së paraqitur nga OE "EJONA" Sh.p.k., e cila është shpërblyer me kontratë dhe e mbrojtur nga AK në vendimin e kontestuar.

Sipas nenit 108/A paragrafi 12 të LPP, kundërshtimet e parashtruara në përputhje me paragrafin 8 dhe 10 të këtij neni duhet të jenë të arsyetuara. Po ashtu, neni 48 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton standardin minimal që duhet të përmbajë çdo akt administrativ për tu konsideruar i ligjshëm. Konkretisht, përcakton se arsyetimi i një akti administrativ duhet të përmbajë qartë përshkrimin e shkurtër të kërkesës së palës, situatën faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet që kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore dhe arsyen e aplikimit të saj në rastin konkret, si dhe arsyet për mospranimin e pretendimeve të palës. Nëse këto elemente mungojnë ose janë të paqarta, ligji e barazon një vendim të tillë me mungesë arsyetimi.

Në rastin konkret, arsyetimi i vendimit të kontestuar nga Autoriteti Kontraktues nuk përfshin asnjë analizë apo vlerësim lidhur me secilin nga pretendimet e paraqitura nga pala ankues. Në vend të një analize të detajuar mbi pretendimet e paraqitura nga pala ankues, AK është mjaftuar me pohime të përgjithshme dhe konstatime subjektive, duke deklaruar se ka vepruar në harmoni me LPP dhe se OE fitues i ka plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë.

Më tej, për secilin pretendim është dhënë një arsyetim i njëjtë, shabllon, i cili përmbillet me formulimin standard: "Këto pretendime nuk qëndrojnë dhe refuzohen si të pabazuara." Një arsyetim i tillë nuk përmbush as kriterin minimal të kërkuar me ligj, pasi nuk sqaron bazën faktike dhe juridike të vendimit, nuk identifikon shkaqet vendimtare gjatë vlerësimit të provave dhe nuk ofron arsye të argumentuara për mospranimin e pretendimeve tona.

Për më tepër, arsyetimi i mangët i Zyrës së Prokurimit nuk përputhet me realitetin, konkretisht me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe me kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 59, në lidhje me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2, 4 dhe 6 pika (i) dhe (iii), nenin 27, nenin 28, nenin 51 paragrafët 1, 2 dhe 3, si dhe nenin 69 paragrafi 1 dhe paragrafët 6.3 dhe 6.4 të LPP-së, si dhe nenin 17 paragrafi 17 të RRPP-së. Si rezultat, vendimi i Autoritetit Kontraktues mbetet i paarsyetuar dhe i kontestueshëm.

Përfundim:

Në bazë të argumenteve të paraqitura, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk përmbush standardet ligjore të arsyetimit dhe është marrë në kundërshtim me kriteret e dosjes së tenderit dhe dispozitat përkatëse të LPP-së dhe RRPP-së. Si i tillë, ky vendim duhet të shpallet i paarsyetuar, i paligjshëm dhe i kontestueshëm.

Provë: Ju lutem shihni vendimin e AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Në vijim paraqiten pretendimet ankimore të dorëzuara pranë autoritetit kontraktues në kuadër të Kërkesës për Rishqyrtim të datës 18.08.2025.

Pretendimi i dytë (II) i KR Duke ju referuar dokumentit B58 - Njoftim mbi vendimin e AK dhe Letrës Standarde për OE "AVAG GROUP", nga ana e Autoritetit Kontraktues është konstatuar se oferta jonë është kualifikuar si ofertë e përgjegjshme, duke përmbushur të gjitha kërkesat e specifikuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Nga ana tjetër, siç dëshmohet nga faktet e paraqitura në pikat e mësipërme, oferta e OE të rekomanduar për kontratë rezulton të jetë e papërgjegjshme, pasi nuk i ka përmbushur një pjesë të konsiderueshme të kërkesave themelore të kualifikimit dhe teknike.

Në këto rrethana, duke qenë se oferta jonë është e renditur si e dyta për nga çmimi dhe i përmbush në tërësi kërkesat ligjore, teknike dhe të kualifikimit, atëherë sipas nenit 60 paragrafi 1.1 të LPP, oferta jonë duhet të kualifikohet dhe të përzgjidhet si oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët. Duke u mbështetur në këtë gjendje faktike, i rekomandojmë OSHP që të detyrojë Autoritetin Kontraktues të rishqyrtojë vendimin e marrë dhe të shpallë ofertën tonë si tenderin fitues, në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-së dhe parimet e barazisë dhe transparencës në prokurim publik.

Pretendimi i tretë (III) i KR Me datë 15.08.2025 kemi siguruar qasje zyrtare në dosjen e OE "EJONA" Sh.p.k., të cilën AK e ka shpallur fitues për LOT II. Megjithatë, qasja nuk na është lejuar në mënyrë të plotë, ashtu siç përcaktohet me nenin 10 paragrafët 4 dhe 5 të LPP-së dhe me Interpretimin 31 të KRPP-së, pasi që qasja ka qenë e kufizuar dhe e pjesshme.

Konkretisht, na është refuzuar dokumentacioni i bashkëngjitur në dosjen e tenderit të OE fitues si më poshtë:

Kontratat valide ose marrëveshjet e punës me punëtorët e angazhuar në projekt, diplomat ose certifikatat profesionale përkatëse, si dhe CV-të, në lidhje me kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional – pika 1 e nenit 9.1 & 9.2 të FTD të DT;

Lista e kontratave të përfunduara gjatë periudhës trevjeçare të fundit, e nënshkruar dhe vulosur nga OE, duke përfshirë referencat ose procesverbalet e pranimit përfundimtar, në lidhje me kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional – pika 2 e nenit 9.1 & 9.2 të FTD të DT;

Dëshmitë dhe dokumentacioni lidhur me specifikimet teknike të kërkuara sipas Aneksit 1 dhe përshkrimit vijues pas aneksit në DT.

Për këto arsye, më datë 18.08.2025 kemi parashtruar një kërkesë plotësuese në drejtim të AK - MPB për të na siguruar në formë elektronike një kopje të materialit të lartcekur nga dosja e OE-së. Lidhur me këtë kemi pranuar përgjigje nga AK, por jo edhe dokumentet e kërkuara, me justifikimin se OE i ka deklaruar si "sekret afarist".

Ky justifikim nuk përputhet me kriteret ligjore, pasi sipas nenit 11 paragrafët 3 dhe 4 pika (i), (ii) dhe (iii) të LPP-së dhe nenit 11.4 të RRPP-së, si dhe nenit 7 të RRPP-së, dokumente të tilla si CV-të, diplomat, certifikatat profesionale, kontratat e përfunduara me referenca apo procesverbalet përfundimtare nuk konsiderohen si sekret afarist, por janë dokumente që duhet të jenë të qasshme për palët në procedurë.

Gjithashtu, OE i rekomanduar me kontratë në Aneksin 3 - "Kërkesë për sekret afarist", nuk ka dhënë asnjë arsyetim bindës se pse këto dokumente duhen përjashtuar nga qasja, por vetëm ka bërë një deklaram të përgjithshme se mund të keqpërdoren nga palët e treta.

Provë: Ju lutem shihni në shtojcën e kësaj ankese, si dëshmi, kërkesën për sekret afarist të shkëputur nga dosja e OE-së të lartcekur.

Një deklaram i tillë nuk përmbush kërkesën e nenit 7.6 të RRPP-së dhe nenit 11 të LPP-së, që detyrojnë operatorin ekonomik të arsyetojë veçmas për secilin dokument. Po ashtu, sipas nenit 11 të LPP-së, operatori ekonomik duhet t'i identifikojë ("markojë") dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngarkimit në sistemin elektronik, ndërsa autoriteti kontraktues duhet të bëjë klasifikimin dhe të përgatisë versione të pastruara të dokumenteve, duke siguruar qasje në pjesët jo-konfidenciale.

Në këtë rast, AK ka kufizuar qasjen në mënyrë të përgjithshme, duke mohuar tërësisht të drejtën për qasje, gjë që përbën shkelje materiale të LPP-së dhe të parimit të transparencës.

Përfundim: Në këto rrethana, kufizimi i qasjes është i pajustificuar në kontekstin e neneve 10 dhe 11 të LPP-së dhe nenit 7 të RRPP-së dhe ka cenuar të drejtën tonë për të ushtruar mjete juridike efektive, duke na pamundësuar që të paraqesim në mënyrë më të plotë dhe më të argumentuar pretendimet tona lidhur me mospërmbushjet e tjera të dosjes së tenderit nga ana e OE fitues.

### 3. Përfundim me propozime

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha arsyet, faktet dhe provat e paraqitura si më lart, OE ankues "AVAG GROUP" Sh.p.k. i drejtohet OSHP-së me këtë ankesë, duke kërkuar që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, administrimit të shkresave të lëndës dhe provave në shqyrtim kryesor, e në pajtim me nenet 104, 105, 107 dhe 117 të LPP-së, të vendosë në favor të ankesës sonë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Global Holding SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Rregulloren e Udhëzimit Operativ për Prokurim Publik.

Me datë 13.08.2025, përmes platformës elektronike të e-Prokurimit, jemi njoftuar me vendimin e AK-së lidhur me shpërblimin e kontratës për aktivitetin në fjalë. Në përputhje me nenin 10 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenin 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, kemi dorëzuar kërkesë për qasje në dokumentacionin.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorit Ekonomik të shpërblyer me kontratë, kemi konstatuar shkelje të rëndësishme në përmbushjen e kriterëve të kërkuara në Dosjen e Tenderit, të cilat e bëjnë këtë OE të papërgjegjshëm dhe, për pasojë, të papranueshëm për shpërblim të kontratës.

Mund të thuhet se gjatë procedurës së vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së, për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, si dhe me dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE-ve në procesin e vlerësimit.

Pas kësaj, ne kemi vazhduar me kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së të dorëzuar me datë 18.08.2025, derisa refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 26.08.2025. Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues nuk është i bazuar në fakte dhe nuk e pasqyron gjendjen reale dhe faktike të procedurës së prokurimit.

Në vijim të kësaj ankese, do të paraqesim në mënyrë të qartë, të detajuar dhe të argumentuar secilin nga pretendimet tona ankimore. Këto pretendime do të mbështeten në prova konkrete, përmes të cilave vërehet qartë se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe me obligimet që burojnë nga dokumentet e tenderit. Ankesa është për LOT 1.

Gjatë analizimit të dokumenteve të ofruara nga OE i rekomanduar “LURN” SH.P.K, kemi vërejtur se është i papërgjegjshëm.

#### Pretendimi 1

Operatori Ekonomik “LURN” SH.P.K nuk është i përgjegjshëm pasi nuk ka ofruar dëshmi se ka përfunduar kontrata për mirëmbajtje teknike apo të ngjashme, konform kriterëve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje Tenderit. Kanë ofruar listë të kontratave, por bazuar në kriteret e përcaktuara nga AK, kemi vërejtur se kontratat së bashku me referencat e OE-së nuk arrijnë vlerën e përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe DT dhe gjithashtu nuk janë të ngjashme, pasi shumica janë furnizime dhe instalime.

Konform Ligjit për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesit 002/2024, përcaktohet qartë se nëse lista e kontratave nuk përmbush vlerën minimale të vlerës së përcaktuar, tenderi duhet të refuzohet automatikisht.

Shih: “Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm” (neni 69).

Ne kërkojmë që për këtë pikë OE i rekomanduar të shpallet i papërgjegjshëm, ngase nuk plotëson kërkesat e AK-së dhe sipas LPP-së dhe Udhëzuesit 002/2024, kjo përbën arsye për refuzim automatik të tenderit. Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe kërkesat e tenderit.

#### Pretendimi 2 – OE LURN SH.P.K i papërgjegjshëm

Në një procedurë në të cilën AK ka rekomanduar për shpërblim me kontratë një OE që, sipas pretendimeve tona, është në kundërshtim të plotë me parimet e transparencës, ekonomikutit dhe efikasitetit. Në LOT 1, në të cilin AK ka rekomanduar këtë OE, në një kalkulim të thjeshtë dhe të qartë, ky OE ka ofruar një ofertë financiare me një çmim total të përgjithshëm të ofertës për 36 muaj në shumë prej 149,040.00 €.

Në kalkulimin e tij për një muaj, i bie që oferta të jetë në shumën mujore prej 4,140.00 €, ndërsa në listën e prezantuar dhe në dëshmitë e prezantuara për stafin, të cilin është i obliguar ta angazhojë për ekzekutimin e kësaj kontrate, në shumën totale të kalkulimit të pagave ky OE ka prezantuar një staf për mirëmbajtje, duke përfshirë edhe menaxherin e këtij Loti. Pas kalkulimit të pagave të stafit, i bie që paga mujore për këtë Lot të jetë në shumë totale prej 4,350.00 €, duke mos përfshirë këtu edhe kontributet dhe shpenzimet tjera që rrjedhin nga ekzekutimi i një kontrate të tillë.

Të nderuar, i bie që ky OE të shërbejë në institucionet e Republikës së Kosovës me një humbje mujore prej jo më pak se -210.00 € në muaj, dhe në kalkulimin e kontratës së përgjithshme për 36 muaj, humbje në shumë prej -7,560.00 €.

Pra, në një procedurë të këtillë, i bie se ky OE ka bërë kalkulim të gabuar në ofertë, ose më saktë, ka futur në lajthitje AK-në duke ofruar një ofertë më të lirë se OE pjesëmarrësit tjerë.

Nga dokumentacioni i ofertës dhe listës së prezantuar të stafit për ekzekutimin e kontratës (përfshirë edhe menaxherin), vërehet se vetëm kostoja mujore e pagave të stafit të angazhuar kap shifrën 4,350.00 €, pa përfshirë këtu:

Kontributet pensionale e tatimore; Shpenzimet operative; Fitimin minimal të OE-së; Shpenzime të tjera administrative dhe logjistike. Kjo rezulton në një humbje mujore prej -210.00 €, përkatësisht -7,560.00 € humbje totale gjatë gjithë kontratës. Ky fakt ngre dyshime serioze: Ose OE ka bërë një kalkulim të gabuar, gjë që tregon mospërgatitje dhe mungesë përgjegjësie; Ose qëllimisht ka synuar të lajthisë Autoritetin Kontraktues me një çmim nën-kosto për të fituar kontratën në mënyrë jo të drejtë.

Këto përbëjnë arsye për eliminimin automatik të ofertës. Kërkojmë që edhe ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe kërkesat e tenderit, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën e OSHP-së.

Pretendimi 3 – OE LURN SH.P.K i papërgjegjshëm Gjithashtu, në stafin e prezantuar nga ky OE: Një (1) Teknik (Instalues i ujit dhe kanalizimit); Dhe te kërkesa e kujdestarisë: Një (1) Teknik (Instalues i ujit).

Për të gjithë këta teknikë ka prezantuar diploma universitare, madje për një (1) Teknik të Makinerisë ka prezantuar Diplomë Master, gjë e cila bie ndesh me parimet bazë njerëzore dhe profesionale. Ky OE, duke ofruar një staf të mbikualifikuar, ka vënë në lajthitje AK-në. Kërkesat e AK-së kanë qenë shumë të qarta, duke kërkuar për menaxherin e kontratës minimumi një Bachelor të diplomuar, dhe për stafin teknik të cilët do të angazhohen në ekzekutimin e kontratës të paraqiten diploma ose certifikata.

Ju lutem që të keni parasysh pretendimin tonë dhe të eliminoni këtë OE të papërgjegjshëm.

Duke pasur parasysh të gjitha këto dëshmi, vijmë në përfundim se OE “LURN” SH.P.K, i rekomanduar për kontratë, është i papërgjegjshëm dhe duhet të eliminohet nga procedura, pasi nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Bazuar në rregullat e Ligjit për Prokurimin Publik, këto përbëjnë arsye për eliminimin automatik të ofertës. Duke u bazuar në argumentet e lartcekura, kuptohet qartë se OE “LURN” SH.P.K, i rekomanduar për kontratë, është i papërgjegjshëm dhe duhet të eliminohet nga procedura për të gjitha LOT-et.

Kërkojmë që këto pretendime të merren seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën e OSHP-së.

Duke u bazuar në argumentet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar dhe njëkohësisht është arsyetim “blanko”, duke mos

dhënë asnjë arsytim se përse pretendimet tona ankimore janë të pabazuara. Andaj, ky veprim i AK-së e tregon qartë faktin se pretendimet tona ankimore janë të bazuara.

Marrë parasysh të gjitha këto dëshmi, vijmë në përfundim se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet automatikisht nga konkurrenca, e jo të favorizohet duke u shpallur fitues i këtij tenderi.

Kërkojmë që edhe këto pretendime të merren seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën e OSHP-së.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar Nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si Operator Ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të lirë. Paragrafi 1 i Nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Po ashtu, paragrafi 6 i Nenit 7 të LPP-së parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse. Mirëpo, ju nuk i jeni përmbajtur kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu, AK nuk e ka respektuar edhe Nenin 6 të LPP-së, ndonëse autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në Nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe Nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për AVAG GROUP SH.P.K:

Detale dhe argumente për pretendimet e neneve të shkelura dhe pikat ankimore për rishqyrtim të lartcekura nga OE, Autoriteti Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme, konstaton se ka vepruar në harmoni të plotë me LPP-në dhe nenet: Neni 1 Qëllimi; Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo diskriminim. Ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE ofertues në harmoni të plotë me Nenin 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe Nenin 40 të Rregullores A01 - Rregullore Nr.002/2024 për Prokurimin Publik – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dhe në harmoni me LPP-në Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës me kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit, duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE-të.

Kriteri për dhënie të kontratës është oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë dhe mbi këtë bazë AK-MPB ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE-të në këtë aktivitet prokurimi. Ministria e Punëve të Brendshme - ZPP, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore, të tenderuesit OE "Global Holding" SH.P.K., Rr. Luan Haradinaj, 10000, Prishtinë. Pas analizës së pretendimeve të cekura në kërkesën për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të publikuar me datën 13.08.2025, konstaton se AK-MPB i ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe

pa diskriminim të gjithë tenderuesit pjesëmarrës, përfshirë edhe Juve, në këtë aktivitet prokurimi, në harmoni të plotë me LPP-në dhe aktet tjera dytësore mbi prokurimin publik të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

#### Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1

Pretendimi i tenderuesit ankues AVAG GROUP SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rruga Mbreti Genc, MATI 1 NR.C-04-01, 10000 Prishtinë, se Operatori Ekonomik "EJONA" SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja, nuk ka plotësuar kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe DT, si më poshtë, nuk qëndron.

Autoriteti Kontraktues ju sqaron se ka vepruar në harmoni të plotë me LPP-në dhe nenet: Neni 1 Qëllimi; Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo diskriminim. Ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE ofertues në harmoni të plotë me Nenin 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe Nenin 40 të Rregullores A01 - Rregullore Nr.002/2024 për Prokurimin Publik – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dhe në harmoni me LPP-në Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës me kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit, duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE-të.

Kriteri për dhënie të kontratës është oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë dhe mbi këtë bazë AK-MPB ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE-të në këtë aktivitet prokurimi. OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në Njoftim për Kontratë dhe DT për kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Operatori Ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të paraqesë stafin teknik profesional për ekipin menaxhues, sepse i njëjti ka aplikuar në tri lloje dhe ka stafe të mjaftueshme të profilit që Ju pretendoni dhe i njëjti OE është shpërblyer vetëm për një lloj, ndërsa stafi i prezantuar i përmbush të gjitha kërkesat e AK-së.

Edhe një herë ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në Njoftim për Kontratë dhe DT. Lista e kontratave të përfunduara në lëmin e kërkuar – mirëmbajtje teknike ose të ngjashme, e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, i plotëson kërkesat e AK-së lidhur me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit për mirëmbajtje teknike. Mirëmbajtja teknike e ndërtesave përfshin në vete mirëmbajtje të pajisjeve, demolime, renovime, izolime, hidroizolime (referoju specifikave teknike të Aneksit 1 të DT-së dhe natyrës së këtij aktiviteti), dhe referencat e dorëzuara nga OE fitues për këtë Lot janë të gjitha të kësaj natyre. Si rrjedhojë, pretendimi Juaj në këtë pikë është i pabazuar.

Ndërsa sa i përket planit organizativ të punëve, veglave dhe makinerisë e çështjeve të tjera që Ju pretendoni lidhur me këtë pikë, nuk qëndrojnë, sepse këto kërkesa janë gjatë realizimit të kontratës e të njëjtat nuk janë kërkesa të vlerësimit. OE ka dorëzuar deklaratën mbi specifikat teknike se të gjitha shërbimet do të ofrohen në pajtueshmëri të plotë me specifikat teknike të DT-së. Andaj këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë dhe refuzohen si të pabazuara.

#### Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2

Pretendimi i tenderuesit ankues AVAG GROUP SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rruga Mbreti Genc, MATI 1 NR.C-04-01, 10000 Prishtinë, se është e përgjegjshme për Lotin II nuk qëndron. Tenderi Juaj është administrativisht i papërgjegjshëm për këtë Lot, pasi nuk keni dorëzuar fare kapacitetin teknik dhe profesional sipas kërkesave të vendosura nga AK në Njoftim

për Kontratë dhe DT dhe nuk i plotësoni kërkesat për të dy llojet me stafin e ofruar. OE Juaj është klasifikuar i përgjegjshëm për Lotin I, sepse keni pasur çmimin më të lartë në atë Lot. Ky pretendim nuk qëndron dhe refuzohet si i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 3

Autoriteti Kontraktues ju sqaron se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në Njoftim për Kontratë dhe DT për kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale për stafin teknik profesional dhe lista e kontratave të përfunduara në lëmin e kërkuar – mirëmbajtje teknike ose të ngjashme, e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, i plotëson kërkesat e AK-së lidhur me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit për mirëmbajtje teknike. Mirëmbajtja teknike e ndërtesave përfshin në vete mirëmbajtje të pajisjeve, demolime, renovime, izolime, hidroizolime (referoju specifikave teknike të Aneksit 1 të DT-së dhe natyrës së këtij aktiviteti), dhe referencat e dorëzuara nga OE fitues për këtë Lot janë të gjitha të kësaj natyre. Si rrjedhojë, pretendimi Juaj në këtë pikë është i pabazuar.

Gjithashtu Ju keni pasur qasje në harmoni me LPP-në Neni 10 dhe Rregulloren Nr.002/2024 Neni 7 Informata sekrete afariste dhe qasja në dokumentacion, versioni i pastruar, pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar kërkesën për sekret. Ky pretendim nuk qëndron dhe refuzohet si i pabazuar.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim për Global Holding SH.P.K:

Detale dhe argumente për pretendimet e neneve të shkelura dhe pikat ankimore për rishqyrtim të lartcekura nga OE, Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, konstaton se ka vepruar në harmoni të plotë me LPP-në dhe nenet: Neni 1 Qëllimi; Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo diskriminim. Ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE ofertuese në harmoni të plotë me Nenin 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe Nenin 40 të Rregullores A01 – Rregullore Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dhe në harmoni me LPP-në Neni 60 Kriteret për Dhënie të Kontratës me kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE-të. Kriteri për dhënie të kontratës ishte oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë dhe mbi këtë bazë AK – MPB ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE-të në këtë AP.

Ministria e Punëve të Brendshme – ZPP, pas pranimi të Kërkesës për Rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore, të tenderuesit OE “Global Holding” SH.P.K., Rr. Luan Haradinaj, 10000, Prishtinë. Pas analizës së pretendimeve të cekura në Kërkesën për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të publikuar me datën 13.08.2025, konstaton se AK – MPB i ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë tenderuesit pjesëmarrës, përfshirë edhe Juve, në këtë AP, në harmoni të plotë me LPP-në dhe aktet tjera dytësore mbi prokurimin publik të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1

Pretendimi i tenderuesit ankues AVAG GROUP SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rr. Mbreti Genc, MATI 1 NR.C-04-01, 10000 Prishtinë, se Operatori Ekonomik “Rruga Ejona” SH.P.K., Zahaq, 30000, Pejë, nuk ka plotësuar kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional të përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe DT, siç është pretenduar, nuk qëndron.

Autoriteti Kontraktues ju sqaron se ka vepruar në harmoni të plotë me LPP-në dhe nenet: Neni 1 Qëllimi; Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo diskriminim, duke trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE ofertuese, në harmoni të plotë me Nenin 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe Nenin 40 të Rregullores A01 – Rregullore Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, si dhe në harmoni me LPP-në Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Kriteri për dhënie të kontratës ishte oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë dhe mbi këtë bazë AK – MPB ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE-të në këtë AP.

OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në Njoftim për Kontratë dhe DT për Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Operatori Ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të paraqesë stafin teknik profesional për ekipin menaxhues, sepse i njëjti ka aplikuar në tri lloje dhe ka stafe të mjaftueshme të profilit që ju pretendoni. I njëjti OE është shpërblyer vetëm për një lloj dhe staf i prezantuar i përmbush të gjitha kërkesat e AK-së.

Edhe njëherë ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në Njoftim për Kontratë dhe DT. Lista e kontratave të përfunduara në lëmin e kërkuar – mirëmbajtje teknike ose të ngjashme – e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e AK-së lidhur me natyrën e këtij Aktiviteti të Prokurimit për mirëmbajtje teknike. Mirëmbajtja teknike e ndërtesave përfshin në vete mirëmbajtje të pajisjeve, demolime, renovime, izolime dhe hidroizolime (referoju specifikave teknike të Aneksit 1 të DT-së dhe natyrës së këtij aktiviteti) dhe referencat e dorëzuara nga OE fitues për këtë Lot janë të gjitha të kësaj natyre. Si rrjedhojë, pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.

Ndërsa, sa i përket planit organizativ të punëve, veglave dhe makinerisë, e çështjeve të tjera që ju pretendoni lidhur me këtë pikë, nuk qëndrojnë, sepse këto kërkesa vlejnë gjatë realizimit të kontratës dhe të njëjtat nuk janë kërkesa të vlerësimit. OE ka dorëzuar Deklaratën mbi specifikat teknike se të gjitha shërbimet do të ofrohen në pajtueshmëri të plotë me specifikat teknike të DT-së.

Andaj këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë dhe refuzohen si të pabazuara.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2

Pretendimi i tenderuesit ankues AVAG GROUP SH.P.K.; H & S Partners Group SH.P.K., Rr. Mbreti Genc, MATI 1 NR.C-04-01, 10000 Prishtinë, se është e përgjegjshme për Lotin II nuk qëndron. Tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm për këtë Lot, pasi nuk keni dorëzuar fare dokumentacionin për Kapacitetin Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të vendosura nga AK në Njoftim për Kontratë dhe DT, dhe nuk plotësoni kërkesat për të dy lloje me stafin e ofruar. OE ju ka klasifikuar të përgjegjshëm për Lotin I, sepse keni pasur çmimin më të lartë në atë Lot.

Ky pretendim nuk qëndron dhe refuzohet si i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 3

Autoriteti Kontraktues ju sqaron se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në Njoftim për Kontratë dhe DT për Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale për stafin teknik profesional. Lista e kontratave të përfunduara në lëmin e kërkuar – mirëmbajtje teknike ose të ngjashme – e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e AK-së lidhur me natyrën e këtij Aktiviteti të Prokurimit për mirëmbajtje teknike. Mirëmbajtja teknike e ndërtesave përfshin në vete mirëmbajtje të pajisjeve, demolime, renovime, izolime dhe hidroizolime (referoju specifikave teknike të Aneksit 1 të DT-së dhe natyrës së këtij aktiviteti), dhe referencat e dorëzuara nga OE fitues për këtë Lot janë të gjitha të kësaj natyre. Si rrjedhojë, pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.

Gjithashtu, ju keni pasur qasje në harmoni me LPP-në, Neni 10 dhe Rregulloren Nr. 002/2024 Neni 7 Informata Sekrete Afariste dhe Qasja në Dokumentacion – versioni i pastruar, pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Kërkesën për Sekret.

Ky pretendim nuk qëndron dhe refuzohet si i pabazuar.

Raportin e ekspertizës me nr.0850/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, OE është pajtuar rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0590/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE AVAG GROUP SH.P.K., ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0850 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendim nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues ka të bëjë me kërkesat teknike dhe profesionale të cilat sipas kërkesave të FDT -se Për Lot- II Kërkesa: 6)- Një (1) Teknike (ventilim – klimatizim-ngrohje)

Deshmia: 6) Për teknikun Diploma ose Certifikata -profesionale përkatëse kopje, CV, kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën si me lartë nga fakti se s'afat i propozuar për këtë kërkesë nuk e posedon certifikatën apo diplomën relevante në mënyrë që të kualifikohet në këtë pikë.

OE i rekomanduar për kontratë në oferte ka propozuar A.L i cili posedon diplomën për kryerjen e shkolles së mesme të lartë në SHMP SH. Spahija në Pejë, me nr protokoli: 01-1374 me drejtim “MAKINERI” dhe profilin “METALPUNUES”.

Ekspteri shqyrtues vlerëson se kërkesa e AK-se në këtë pikë ka qenë specifike duke kërkuar Teknik, (ventilim – klimatizim-ngrohje) ndërsa me ofertë është dorëzuar drejtimi Makineri me profilin Metalpunues e cila nuk ka të bëjë fare me drejtimin që është kërkuar prandaj AK- gjaatë vlerësimit të ofertave në këtë pikë ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-se, nenin 4.3 paragrafi c dhe nenin 40.6 paragrafi c, si dhe 40.7 të RRPP 002/2024.

Vlen të theksohet se AK gjatë vlerësimit të ofertës së OE ankues, stafin e prezantuar nga ky operator e ka konsideruar si staf të dedikuar për LOT 1, edhe pse në ofertë nuk është specifikuar se për cilin LOT është ofruar ky staf. Në këtë mënyrë, AK e ka eliminuar ofertën e OE ankues me arsyetimin se nuk ka prezantuar staf fare për LOT 2.

Ndërkaq, me rastin e vlerësimit të ofertës së OE të rekomanduar për LOT 2, edhe pse ky operator ka prezantuar staf specifikisht të dedikuar për LOT 2 me të cilin në piken e pershkuar me lartë nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, AK gjatë përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim e ka arsyetuar vendimin e tij duke thënë se, edhe pse stafi i prezantuar për atë LOT nuk i plotëson kushtet e përzgjedhjes, OE i rekomanduar posedon staf të mjaftueshëm që mund të merret nga stafi i prezantuar për LOT-et tjera.

AK, në këtë mënyrë, ka përdorur standarde të dyfishta gjatë vlerësimit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe se pretendimi është i bazuar.

#### Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi ankimor i OE ankues ka të bëjë me kërkesat teknike profesionale të cilat sipas kërkesave të FDT-se është kërkuar:

2. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojë se ka kontratë të përfunduara në lëmin e kërkuar-mirëmbajtje teknike ose të ngjashme (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) të gjitha së bashku në vlerë prej jo më pakë së për:

LOT -II - 200,000.00 €;

2. Lista e kontratave të përfunduara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte të realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar.

Kur janë realizuar për autoritetin publik, si dëshmi për këtë realizim do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) ose referencës përkatëse të lëshuar nga autoriteti i tillë publik.

Ndërsa për kontratë të cekura në listë; që janë realizuar për blerësin privat, dëshmi për këtë realizim duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë, (si dëshmi duhet të ketë dëshmi nga banka). duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kriterin e kërkuar për përvojë në projekte të ngjashme në vlerë prej 200,000 €, sipas listës së projekteve të dorëzuara

me ofertë.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë, me ofertë, ka dorëzuar një listë prej 51 projekteve. Eksperti shqyrtues sqaron se lista e kontratave nuk perputhet me referencat e dorëzuara dhe si rrjedhojë nuk mund të vlerësohet vlera e projekteve të realizuara sipas listës. Për më tepër lista e projekteve ka të përfshirë projekte të cilat nuk hyjnë në periudhën e shkuar trivjeqare të kërkuar me FDT.

Pas administrimit të provave (listës dhe referencave), eksperti shqyrtues vlerëson se projektet e përfshira në listë, duhej të identifikoheshin dhe të vlerësoheshin nga AK në bazë të FPP-së dhe kërkesave të FDT-se. rrjedhimisht, AK gjatë vlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 40.2, 40.6 dhe 40.7 të RRPP 002/2024 dhe se pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

OE ankues në këtë pikë pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka dorëzuar dokumentet e kërkuara me Aneksin 1 të specifikimeve teknike konkretisht me kërkesën për:

Përveç dokumenteve të kërkuara në Udhëzimet,

Kompania fituese obligohet të dorëzojë, si pjesë të ofertës së tyre edhe dokumentet sipas specifikimit të mëposhtëm:

1. Plan i organizimit të punëve për realizimin e mirëmbajtjes teknike të ndërtesave sipas Lotëve
2. Plan i organizimit të punëve të kujdestarisë për mirëmbajtje teknike të ndërtesave sipas Lotëve
3. Komfor i planit të organizimit të punëve të mirëmbajtjes teknike duke përfshirë edhe kujdestarin

te përgatit skemën organizative - organo gram strukturor me thirrjet e vendeve të punës, numrin e kryesve dhe kualifikimet e punëtorëve të planifikuar për secilin Lot për të cilin oferton,

4. Specifikimin e makinerisë-automjeteve të cilën e posedon kompania - për secilën makinë – automjet të paraqitur duhet dorëzuar dëshminë mbi pronësinë e kompanisë, (kopjen e librezës së regjistrimit ose),

5. Specifikimin e veglave dhe mjeteve për punë të cilat i posedon kompania .

Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa për dokumentet pjesë e këtij pretendimi sipas dosjes së tenderit janë kërkuar vetëm nga kompania fituese pra është parapare që këto dokumente të dorëzohen vetëm nga kompania e cila rekomandohet për kontratë dhe se nuk ka qenë kriter për zgjedhjen në fazën e ofertimit.

Si rezultat AK gjatë vlerësimit të ofertave në këtë pikë ka vepruar në përputhje me nenin 40 të RRPP 002/2024 dhe se pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar.

Lidhur me pretendimet e OE Global Holding SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0861 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues ka te beje me kerkesat teknike profesionale te cilat sipas kerkesave te FDT-se është kerkuar:

2. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmoj se ka kontrata të përfunduara në lëmin e kërkuar-mirëmbajtje teknike ose të ngjashme (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pakë së për:

LOT -I - 250,000.00 €;

2. Lista e kontratave të përfunduara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte e realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar.

Kur janë realizuar për autoritetin publik, si dëshmi për këtë realizim do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) ose referencës përkatëse të lëshuar nga autoriteti i tillë publik.

Ndërsa për kontrata e cekura në listë; që janë realizuar për blerësin privat, dëshmi për këtë realizim duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë, (si dëshmi duhet të ketë dëshmi nga banka). duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kriterin e kërkuar për përvojë në projekte lëmin e kërkuar-mirëmbajtje teknike ose të ngjashme në vlerë prej 250,000 €, sipas listës së projekteve të dorëzuara me ofertë për shkak se shumica janë furnizime dhe instalime.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë me oferte ka dorëzuar një listë prej 64 projekteve prej të cilave ka projekte nga insitucionet publike dhe private.

Eksperti shqyrtues pas administrimit të provave; ofertes se OE të rekomanduar për kontratë, dokumenteve të vleresimit (raporti të vleresimit, njoftimit për vendim të AK-se, Vendimin në kërkesën për rishqyrtim) vlereson se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listë të projekteve të cilat kanë një numër të madh të projekteve në sektorin privat si dhe projekte në institucione publike të cilat janë në të gjitha fushat sipas FPP-se. AK gjatë vleresimit nuk i ka identifikuar se cilat projekte janë marrë parasysh nga AK, e të cilat e kanë plotësuar kriterin sipas kërkesave të FDT.

Eksperti shqyrtues gjatë administrimit të provave ka gjetur se OE i rekomanduar për kontratë ka një numër të madh të kontratave me KEDS në të cilat nuk janë bashkëngjitur dëshmitë nga banka, ka projekte të cilat janë ndërtim si dhe projekte të cilat sipas fjalorit të FPP-se dhe përshkrimit të kontratës nuk është e mundur që qarte të vlerësohet se a mund të përfshihet në kërkesat sipas kërkesës 2 të FDT-se. Poashtu edhe OE ankues gjatë procedurës së ankimit nuk i ka identifikuar se për cilat projekte sipas OE ankues janë kontestuese dhe nuk mund të përfshihen në vlerësim të ofertes.

Si përfundim eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë administrimit të provave e ka zbatuar pjesërisht kërkesat e UOPP 001/2023 si dhe kërkesat e nenit 40 të RRPP 002/2024 dhe si rrjedhojë konsideron se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi ankimor i OE ankuesit në këtë pikë lidhet me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë. Sipas OE ankuesit, vlera e ofertës së paraqitur nga OE i rekomanduar nuk i përmbush kërkesat dhe obligimet ligjore që rrjedhin nga kontrata, veçanërisht në raport me shpenzimet për stafin e angazhuar, duke përfshirë pagat dhe kontributet pensionale e tatimore.

OE ankuesi pretendon se në ofertën e OE të rekomanduar është bërë kalkulim i gabuar i kostos, çka rezulton në ofertë nën kosto. Për këtë arsye, OE ankuesi vlerëson se oferta e OE të rekomanduar duhet të refuzohet, pasi nuk garanton zbatimin e detyrimeve ligjore dhe kontraktuale.

Në lidhje me pretendimin e OE ankuesit se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është nën kosto dhe, rrjedhimisht, i pamundur realizimi i kontratës, eksperti shqyrtues vlerëson si vijon:

Sipas nenit 41 të RRPP 002/2024, AK është i obliguar të ndërmarrë masa vetëm në rastet kur një ofertë është formalisht e identifikuar dhe e trajtuar si ofertë jonormalisht e ulët. Në këtë procedurë, nuk ka pretendime apo ankesë të drejtpërdrejtë mbi ekzistencën e një oferte jonormalisht të ulët, dhe si e tillë kjo çështje nuk është trajtuar gjatë fazave paraprake të vlerësimit.

Përgjegjësia për realizimin e kontratës i takon plotësisht OE-së së rekomanduar, në përputhje me ofertën e dorëzuar. OE i rekomanduar është i detyruar të përmbushë të gjitha obligimet kontraktuale, përfshirë edhe detyrimet që burojnë nga Ligji i Punës dhe legjislacioni tatimor e pensional, lidhur me organizimin e brendshëm dhe pagesat për stafin e angazhuar.

AK është përgjegjës të monitorojë dhe të kujdeset që kontrata të realizohet në përputhje të plotë me termat dhe kërkesat e kontratës, siç janë përcaktuar në FDT.

Organizimi i brendshëm i OE-së së rekomanduar, struktura e stafit dhe mënyra e menaxhimit të kostove të tij, nuk janë objekt i vlerësimit nga AK, për aq kohë sa këto nuk përbëjnë shkelje të drejtpërdrejtë të kërkesave të FDT-së ose të LPP-se.

Në kriteret dhe kërkesat e FDT-së nuk ka qenë e parashikuar si obligim dorëzimi i një analize të kostos së ofertës. Për rrjedhojë, pretendimi i OE ankuesit mbi mungesën e një llogaritjeje të saktë të pagave dhe kontributeve nuk mund të merret si bazë për refuzimin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, pasi një kërkesë e tillë nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit të tenderit.

Përfundimisht, OE i rekomanduar për kontratë është përgjegjës për përmbushjen e plotë të kontratës sipas ofertës së tij, ndërsa AK mbanë përgjegjësinë për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratës në përputhje me ligjin dhe FDT-në, prandaj pretendimi ankimor i OE ankues në këtë pikë nuk është i bazuar.

### Përgjigje në Pretendimi nr.3

Pretendimi ankimor i OE ankues ka të bëjë me kërkesat teknike dhe profesionale të cilat sipas kërkesave të FDT -se Për Lot- I Kërkesa:

3) - Një (1) Teknik -i Hidroteknikes (Instalues i ujit dhe kanalizimit)

3) Për teknikun Diploma ose Certifikata -profesionalë përkatëse kopje, CV, kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje.

2) - Një (1) Teknike (Instalues i ujit)

Deshmia: 6) 2) Për teknikun Diploma ose Certifikata -profesionalë përkatëse kopje, CV, kontrata valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt – kopje.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën si me lartë nga fakti se për kërkesat si me lartë ka ofruar diploma universitare që bën ndesh me parimet bazë njerezore dhe profesionale, pra ka ofruar staf të mbikualifikuar duke bërë në lajthitje AK-ne.

OE i rekomanduar për kontratë për kërkesat si me lartë për LOT 1 ka ofruar stafin (B.O) i cili posedon diplomën Bachelor në Fakultetin e Ndërtimitarise dhe Arkitektures me drejtimin Hidroteknik si dhe stafin (N.M), i cili posedon diplomën Bachelor në Fakultetin e Ndërtimitarise dhe Arkitektures me drejtimin Hidroteknik.

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas nenit 8.1 paragrafi 2 të UOPP nr. 001/2023, AK ka të drejtë të përcaktojë në FDT kërkesat minimale që duhet të përmbushin operatorët ekonomikë për të kualifikuar në procedurë.

Po ashtu, në përputhje me nenin 8.2 të UOPP nr. 001/2023, OE-te janë të obliguar të dëshmojnë plotësimin e këtyre kërkesave minimale, në mënyrë që të kualifikohen.

Në rastin konkret, në FDT është përcaktuar kërkesa minimale për ofrimin e stafit profesional si me lartë.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar staf profesional me diplomë Bachelor në Fakultetin e Ndërtimitarise dhe Arkitekturës – drejtimi Hidroteknik, gjë që përbën kualifikim më të lartë sesa minimumi i kërkuar.

Eksperti shqyrtues bazuar në pretendimet ankimore dhe dëshmitë e dorëzuara me oferte vlerëson se AK gjatë vlerësimit të ofertes në këtë pikë ka vepruar në përputhje me nenin 8 të UOPP gjatë përcaktimit të kërkesave të FDT-se si dhe nenin 40 të RRPP-se gjatë vlerësimit të ofertes dhe si rrjedhojë pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të

tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues, andaj paneli shqyrtues pa nevojë për sqarime tjera shtesë e vlerëson si të bazuara ankesat e OE ankuesve të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës për Lot I dhe II, ndërkaq aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik AVAG GROUP SH.P.K., aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI me numër të prokurimit 214-25-4909-2-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës për Lot II dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit në fjalë të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik Global Holding SH.P.K., aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Mirëmbajtja teknike e ndërtesave qeveritare Lot - I,II,III,IV,V dhe VI me numër të prokurimit 214-25-4909-2-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës për Lot I dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit në fjalë të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Kimete Gashi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - AVAG GROUP SH.P.K., " Global Holding " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: